

Terminologji dhe koncepte gjenerativiste të frazës

Orjeta Dushi*

Abstrakt

Qëllimi i kërkimit është pasqyrimi i vlerave kuptimore të termave e të koncepteve gjenerative në sintaksën e gjuhës shqipe. Me futjen në përdorim të metodave përshkruese, krahasuese e shpjeguese si dhe shfrytëzimit të një literature të pasur në shqip dhe në gjuhë të huaj kam arritur rezultatet e mëposhtme:

1) Klasifikimi i fjalive, duke u mbështetur në kundërvënien mes fjalive kryesore dhe fjalive të varura bëhet sipas këtyre këndvështrimeve:

1.1) Në llojin e marrëdhënies që lidh fjalinë e varur me fjalinë drejtuese;

1.2) Forma e fjalisë së varur, e cila mund të jetë identike ose e ndryshme nga ajo e fjalive drejtuese;

1.3) Mënyra e foljes së fjalisë së varur.

2) Njësitë predikative me gjymtyrë funksionale kryejnë funksione paralele.

2.1) Në gjuhët e njohura evropiane tema zakonisht është kryefjalë, dhe rema kallëzues. Në pikëpamjen tradicionale kryefjala e një fjalie veprare kalimtare është autore e veprimit, kurse kundrinori është pësuesi ose synimi. Në gjuhët me ndërtim ergativ karakteristika sintaksore e rasës do të përcaktonte si kryefjalë emrin "synim" të fjalisë jokalimtare.

2.2) Plotësori kallëzuesor është sintaksisht i domosdoshëm për plotësimin e strukturës kallëzuese (prandaj quhet "komplement", përkatësisht "plotës").

2.3) Mbi bazën e numrit të nominaleve me të cilat foljet bashkohen për të formuar bërthamat e fjalive bëhet një klasifikim i foljeve. Sipas këtij klasifikimi bëhet edhe dallimi midis kryefjalës edhe kundrinorit. Modelet aktuale i dallojnë klasat e ndryshme foljore duke supozuar ekzistencën e një kategorie të veçantë funksionale, SV e së cilës është komplement i saj. Kjo kategori është shënuar me *v*. Rrjeti tematik i një zëri të caktuar leksikor është një strukturë me predikat dhe argumente, tipe e analizave të gjuhës, të formuluar nga logjika bashkëkohore.

* Orjeta Dushi, Ph. D. Candidate at the Institute of the Albanian Studies, Shkodër, Albania, E-mail: orjeta.dushi@live.com

Përdorimi i rezultateve të mësipërme sjell risi në terminologjinë gjuhësore dhe konceptuale të sintaksës gjenerative të shqipes.

Fjalët kyçe: Klasifikimi i fjalive, kundërvënie, njësitë predikative, gjymtyrë funksionale, funksione paralele.

Hyrje

Gjenerativizmi është një nga drejtimet e shumta gjuhësore, e njohur edhe me emrin gramatikë gjenerative transformuese, e cila i ka dhënë përgjigje shumë çështjeve teorike lidhur me veçantitë e strukturave gjuhësore. Të flasësh për gjuhësinë transformuese është një sipërmarrje e vështirë, pasi jemi formuar teorikisht dhe praktikisht me koncepte të gramatikës tradicionale. Vështirësia qëndron në përshtatjen e terminologjisë dhe metodave që përdoren jo vetëm në fushën teorike të studimit gjenerativist, por edhe në fushën e zbatimeve praktike të gjuhësisë gjenerative transformuese, bazat e së cilës i ka hedhur gjuhëtari amerikan Noam Avram Çomski. Studimet gjuhësore në këndvështrimin gjenerativist për gjuhësinë shqiptare i përkasin viteve të fundit. Qëllimi i këtij punimi është pasqyrimi i vlerave kuptimore të termave e të koncepteve gjenerative në sintaksën e gjuhës shqipe, kryesisht të frazës (fjalisë së përbërë) dhe të funksioneve paralele të njëjive predikative me gjymtyrë funksionale. Me futjen në përdorim të metodave përshkruese, krahasuese e shpjeguese si dhe shfrytëzimit të një literature të pasur po paraqes rezultatet e arritura.

Prishiani, një gramatikan latin (që ka jetuar në Bizant) i shek.V pas Krishtit e përkufizonte fjalinë si një kombinim koherent fjalësh që shpreh një kuptim të plotë. Pra një formim i mirë i fjalëve, që domethënë një kombinim që shpreh një “kuptim të plotë”. Kuptimi i plotë i përcjellë nga një fjali nuk mund të identifikohet me përmbajtjen e një gjykimi. Fjalitë e varura ose të nënrenditura nuk shprehin një kuptim të plotë, ai jepet nga tërë fjalia komplekse ku bën pjesë.

1) Klasifikimi i fjalive, duke u mbështetur në kundërvënien mes fjalive kryesore dhe fjalive të varura.

Për klasifikimin e fjalive bazohemi te kundërvënia mes fjalive kryesore dhe fjalive të varura, quhen të varura, sepse ekzistojnë fjali të pavarura,¹ pra fjali që qëndrojnë më vete. Me “fjali të thjeshta” sipas Renzit,² kuptojmë fjalitë në të cilat asnjëri prej elementeve nuk përbëhet nga një fjali, pra të gjitha elementet janë të përfaqësuara nga sintagma të llojeve të ndryshme. Po sipas Renzit³ “fjali të përbërë” quajmë një strukturë, ku të paktën njëri prej elementeve është i përfaqësuar nga një fjali. Fjalitë që ndërtojmë në një periudhë mund të jenë në lidhje bashkërenditëse apo nënrenditëse (nënrenditëse është lidhja kur njëra prej fjalive përbërëse karakterizohet si e varur; ndërsa kur asnjëra prej fjalive që formojnë një periudhë nuk paraqet një natyrë fjalie të varur, thuhet se janë të bashkërenditura).

Për fjalitë nënrenditëse klasifikimi bëhet në këto këndvështrime:

1.1) Në llojin e marrëdhënies që lidh fjalinë e varur me fjalinë drejtuese;

1.2) Forma e fjalisë së varur, e cila mund të jetë identike ose e ndryshme nga ajo e fjalive drejtuese;

1.3) Mënyra e foljes së fjalisë së varur.

1.1) Disa gramatika tradicionale sipas këndvështrimit të parë (në llojin e marrëdhënies që lidh fjalinë e varur me fjalinë drejtuese) fjalitë e varura i dallojnë me tri pjesë të ligjëratës:

1.1.1) fjali të varura emërore;

1.1.2) fjali të varura mbiemërore;

1.1.3) fjali të varura ndajfoljore.

1.1.1) Fjalitë e varura emërore dhe ndajfoljore në kuptimin e teorisë së valencës sillen të parat si argumente dhe të dytat luajnë rolin e rrethanorëve, ndërsa për fjalitë mbiemërore në lidhje me valencat kanë një funksion atributiv. Fjalitë e varura emërore në qoftë se lihen jashtë frazës krijojnë një fjali jo-gramatikore. Kjo tregon sjelljen tipike të argumenteve.

¹ G. Graffi, *Sintaksa* (Struktura të ligjëritimit), përktheu në shqip Dr. B.Topalli, Tiranë, Dituria, 2003, fq.131.

² L. Renzi,(a cura di) *Grande grammatica italiana di consultazione. Volume I:La frase. I sintagmi nominale e preposizionale*, Bologna, Il Mulino, 1988, fq. 35.

³ Po aty,fq.35

P.sh. a) Është e mundur që *Xhani të niset nesër*.

a') *Është e mundur.⁴

Kështu që këtë klasë mund ta quajmë fjali argumentuese duke përdorur një term që mbledh elementin e përbashkët të të gjitha njësive: qoftë foljore, emërore, apo ndonjë lloj tjetër, të cilat përfaqësojnë një përmbushje të valencave të foljeve.

Brenda kësaj klase fjalish dallojmë:

1.1.1a) fjalitë kryefjalore. P.sh. Është e mundur (kjo gjë) që *Xhani të niset nesër*.

1.1.1b) fjalitë plotësore-rrethimore (termi “plotësore” shfaqet më i preferueshëm se ai tradicional “kundrinore”). P.sh. *Xhani ka thënë (këtë gjë) që do të niset nesër*.

1.1.1c) fjalitë pyetëse të zhdrejta (apo “pyetëset e varura”). P.sh. *Xhani nuk e di kush do të niset nesër*.

Valenca është një veçori jo vetëm për klasën e foljeve, por edhe për klasën e emrave, të cilët quhen “emra argumentues”. Pra edhe fjalitë e varura mund të jenë argument jo vetëm i foljeve, por edhe i emrave argumentues. P.sh. Fakti që *interneti po shton numrin e përdoruesve* nuk çuditi askënd. Emri “fakt” është emër argumentues.

1.1.2) Fjalitë e varura që gramatika tradicionale i quan mbiemërore u jepet e njëjta domethënie e fjalisë së varur lidhore. Në shqip janë fjalitë e varura përcaktore. Këto fjali dalin në rol mbiemri me funksion modifikues. Kjo shpjegon edhe emërtimin “fjali mbiemërore”.

1.1.2a) Ja disa fjali lidhore përcaktore me paraprijës. P.sh.

*) *Lisi që ishte i madh* është rrëzuar.

**) *Lisi për të cilin kishte folur poeti*, është rrëzuar.

***) *Stuhia ka rrëzuar lisin nën të cilin djali plëngprishës kulloste delet*.

Në këto shembuj kuptojmë që fjalitë lidhore modifikojnë domethënien e emrit-kokë të sintagmës emërore (SE) *lis* që përkufizohet paraprijës i fjalisë lidhore përcaktore.

1.1.2b) Në fjalitë mbiemërore grupojmë vetëm fjalitë lidhore përcaktore me paraprijës, brenda së cilës kemi ndarjen fjali lidhore

⁴ Shënim i autorit : *yllthi tregon jogramatikalitetin e kësaj fjalie.

kufizuese, ku hyjnë fjalitë që modifikojnë domethënien e sintagmës emërore paraprijëse duke kufizuar shtrirjen.

P.sh. Studentët që nuk janë regjistruar në sezon, nuk mund të japin provimin.

1.1.2c) Ndarja fjali lidhore ndajshtimore, përfshin fjali të varura të cilat shtojnë vetëm informacione të mëtejshme.

P.sh. Albani që nuk është regjistruar në sezon, nuk mund të japë provimin.

Ndryshimi mes fjalive lidhore kufizuese dhe fjalive lidhore ndajshtimore është i bazuar si në nivelin semantik, ashtu edhe në nivelin sintaksor.

1.1.2d) Kemi dhe fjali lidhore përcaktore pa paraprijës (quhen ndryshe “të pavarura” apo “të lira”). P. sh. Ai që prek telat vdes.

Fjalitë lidhore të lira modifikojnë një kokë të zbrazët d.m.th jo të realizuar nga ana fonetike.

1.1.3) Fjalitë e përkufizuara ndajfoljore përfshijnë fjalitë që sqarojnë rrethana si:

1.1.3a) fjalia shkakore: Duke qenë se Genci arriti vonë, na u desh të hamë darkë me nxitim. 1.1.3b) fjalia kohore: Kur arriti Genci, mundëm të hamë darkë.

1.1.3c) fjalia qëllimore: Pritëm ardhjen e Gencit, me qëllim që të hamë darkë të gjithë së bashku.

Në sintaksën e shqipes këto fjali quhen “fjali rrethanore”.

1.2) Forma e fjalisë së varur mund të jetë identike ose e ndryshme nga ajo e fjalive drejtuese.

Në bazë të klasifikimit të fjalive të varura sipas formës kemi fjali të varura të shprehura dhe të nënkuptuara.

1.2.1) Fjalitë e varura të shprehura u trajtuan me lart.

1.2.2) Fjali të varura të nënkuptuara janë:

1.2.2a) fjali me folje në paskajore:

P. sh. it. Federico ha promesso a Giulia di studiare ogni giorno. - Frederiku i ka premtuar Xhulias për të studiuar çdo ditë. Në shqip do të thoshim: Frederiku i ka premtuar Xhulias të studiojë çdo ditë. Karakteristikë e këtyre fjalive është se nuk mund të shprehin kurrë fonetikiisht kryefjalën e tyre edhe pse ka një interpretim të përcaktuar

mirë, në rastin tonë është sintagma emërore Frederiku, kryefjala e fjalisë drejtuese.

1.2.2b) *ffali me folje në përcjellore*, ku kryefjala e pashprehur duhet të jetë detyrimisht identike me kryefjalën e fjalisë kryesore, pra nuk mund të jetë identike me kundrinorin e kësaj të fundit. P.sh. it. *Avendo incontrato di nuovo Giulia, Federico non voleva piu vedere Pietro*. Në shqip: Duke pasë takuar përsëri Xhulian, Frederiku nuk donte të shihte më Pjetrin.

1.2.2c) *ffali të shkurtuara*.

P.sh. *) Kanë zgjedhur *Marcon president*.

***) Me *Marcon president*, situata ekonomike mundet veç të përmirësohet.

Quhen kështu sepse shprehin gjithnjë kryefjalën, por nuk kanë një paraprijës fjalie. Pra nëse fjalitë e nënkuptuara shtrihen deri në "periferinë e parë" të strukturës frazale do të thotë që ato përmbajnë në fakt vetëm "qendrën".

P.sh. it. *Cerco una spalla su cui piangere*. Në shqip. Kërkoj një shpatull *mbi të cilën të qaj*.⁵

1.3) Në bazë të klasifikimit të fjalive të varura sipas mënyrës së foljes së fjalisë së varur dimë se në çfarëdo lloj mënyre, kohe dhe vete të jetë folja, valencat e saj nuk ndryshojnë, pavarësisht nga morfemat e ndryshme të eptimit. Te bashkëlidhja e trajtave mënyrore dhe kohore midis fjalive të periudhës duket që folja e fjalisë kryesore përcakton mënyrën dhe kohën e fjalisë së varur, por folja e fjalisë kryesore nuk mund të përcaktojë nga ana leksikore foljen e fjalisë së varur. Pra, të dyja foljet, ndërsa kanë një varësi nga mënyra dhe koha, nuk kanë varësi nga ana leksikore. P.sh. a) *Liraku i vogël ëndërronte të bëhej si ustai i vet*.

Folja e fjalisë kryesore *ëndërronte* përcakton mënyrën (lidhore) e foljes së fjalisë së varur, por nuk e përcakton atë nga ana leksikore. Nga ana leksikore ajo mund të jetë një folje tjetër. Mund të themi edhe *ëndërronte të vishej, të fliste*, etj..

b) Kur hynte treni në stacion, dëgjoheshin disa fishkëllima të zgjatura.

⁵ G.Graffi, *Sintaksa* (Struktura të ligjërimimit), përktheu në shqip Dr. B.Topalli, Tiranë, Dituria, 2003, fq.149-169.

Folja e fjalisë kryesore *dëgjoheshin* përcakton kohën (e pakryer) të foljes së fjalisë së varur *hynte* në kuptimin që, në qoftë se priset kjo bashkëlidhje, periudha nuk është më kohore. Por folja e fjalisë kryesore nuk “urdhëron” që në fjalinë e varur të jetë patjetër folja *hynte*. Mund të jetë edhe një folje tjetër: *ndalonte, nisej, etj.*⁶

2) Funksione paralele të njësive predikative me gjymtyrë funksionale

Shpjegova më lart se kryefjala dhe kallëzuesi janë konstituente-bërthamë, kurse adjuksionet janë konstituente-jobërthamë. Sipas Hockett njeriun ose sendin për të cilin flasim, do t'i quajmë *temë*, kurse thënien mbi njeriun ose sendin – *remë*.

2.1) Në gjuhët e njohura evropiane *tema* zakonisht është edhe kryefjalë, dhe *rema* kallëzues. *Tema*, përkatësisht “objekti i bisedës” përshkruhet si elementi i cili është dhënë në situatën e përgjithshme, ose në një kërkesë pyetje eksplicite së cilës i përgjigjet folësi, kurse *rema*-si pjesë e shprehjes, që jep diçka të re (jep një informacion të mëtejshëm të dëgjuesi). Le të shqyrtojmë fjalinë *Hansi vret Alfredin* bërthama e së cilës përbëhet nga dy emra dhe një folje. *Hansi* është kryefjala dhe kompleksi *vret Alfredin*-kallëzuesi, që është përbërë nga folja kalimtare *vret* dhe nga emri *Alfredin* si kundrinor. Baza themelore e kësaj pikëpamjeje qëndron në rrethanën se midis emrit *Hans* në fjalinë *Hansi vret Alfredin* dhe kryefjalës së një fjalie jokalmimtare, vërehet një paralelizëm gramatikor si dhe midis *vret Alfredin* dhe kallëzuesit të një fjalie jokalmimtare (meqenëse kryefjala dhe kallëzuesi janë përcaktuar me një fjali jokalmimtare, vetëm me një nominal). Në pikëpamjen tradicionale kryefjala e një fjalie veprorë kalimtare është *autore e veprimit*, kurse kundrinori-pësuesi ose synimi. Në gjuhët me ndërtim *ergativ* karakteristika sintaksore e rasës do të përcaktonte si kryefjalë emrin “synim” të fjalisë jokalmimtare. Kryefjala e një foljeje jokalmimtare bëhet kundrinor i foljes kalimtare përkatëse dhe një kryefjalë e re *ergative* futet si veprues (ose shkak) i veprimit të përmendur. Vepruesi *ergativ* ose *kauzativ* (p.sh. Xhoni lëvizi gurin.)

⁶ J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, Shpresa, 2005, fq. 26.

është një emër frymor, karakteristike për kryefjalët e foljeve kalimtare.⁷ Termi “ergativ” vjen nga gr. me kuptimin “shkaktoj”, “bëj”, “prodhoj”.⁸

Kjo është në kundërshtim me pikëpamjen që kryefjala shpesh është vepruesi dhe jo synimi. Shumica e gjuhëtarëve mendojnë se kundrinori i një foljeje kalimtare ka të njëjtin eptim rasor si dhe kryefjala e një foljeje jokalimtare. Në fjalitë pësore synimi dhe jo vepruesi mund të shihet si kryefjalë, sepse vepruesi është një konstituente fakultative, jashtë bërthamore (së paku, në strukturën sipërfaqësore ajo qëndron jashtë nukleusit. *Bill was killed*, është një fjali e plotë, ndërsa * *John killed*,⁹ jo. Kompleksi *by John* në *Bill was killed by John*, tradicionalisht vështrohet si plotësim i mjetit veprues, i cili sintaksisht është i krahasueshëm ndofta me përdorimin e mjetit “instrumental” *whith a knife* në *Bill was killed with a knife*.¹⁰

2.2) Deri tani termi “plotësorë” është përdorur vetëm në lidhje me shprehjet emërore dhe mbiemërore, të cilat bashkohen me këpujën në fjali si: a) *Afërdita është një vajzë e bukur.* dhe b) *Afërdita është e bukur.* Me plotësorë kallëzuesor shënohen të gjitha ato fjalë ose grupe fjalësh (me përjashtim të vetë foljes) që janë konstituente të detyrueshme të kallëzuesit si p.sh. kundrinori i një foljeje kalimtare. Plotësori kallëzuesor është sintaksisht i domosdoshëm për plotësimin e strukturës kallëzuese (prandaj quhet “komplement”, përkatësisht “plotës”). Plotësori përdoret veçanërisht për shprehjet ndajfoljore. Dallimi midis një adjuksioni dhe një plotësori kallëzuesor është i qartë: i pari është një konstituente fakultative (jobërthamë) e fjalisë, kurse i fundit konstituente e detyrueshme (bërthamë).¹¹

2.3) Mbi bazën e numrit të nominalëve me të cilat foljet bashkohen për të formuar bërthamat e fjalive bëhet një klasifikim i foljeve. Sipas

⁷ J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, përktheu në shqip Prof. Dr. E. Likaj, Tiranë, Dituria, 2001, fq. 326-327.

⁸ Shënim i autorit.

⁹ Shënim i autorit : *yllthi tregon jogramatikalitetin e kësaj fjalie.

¹⁰ J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, përktheu në shqip Prof. Dr. E. Likaj, Tiranë, Dituria, 2001, fq. 311-318.

¹¹ J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, përktheu në shqip Prof. Dr. E. Likaj, Tiranë, Dituria, 2001, fq. 320-321.

këtij klasifikimi bëhet edhe dallimi midis kryefjalës edhe kundrinorit, sepse arsyet lidhen me problemet e kalimtarësisë dhe diatezës së foljes. Në bazë të klasifikimit një folje si *vdës* kërkon vetëm një emër, pra një argument që të përftojë bërthamën. Kjo quhet folje e njëvlershme. Një folje kalimtare është e dyvlershme, ku njëra valencë zihet nga kryefjala, kurse tjetra nga kundrinori. Për foljet e trivlershme themi se e përftojnë bërthamën kur bashkohen me një kryefjalë, me një kundrinor të drejtë dhe me një kundrinor të zhdrejtë.

Modelet aktuale i dallojnë klasat e ndryshme foljore duke supozuar ekzistencën e një kategorie të veçantë funksionale (kategori funksionale është koha gramatikore, p.sh. e ardhmja), SV e së cilës është komplement i saj. Kjo kategori është shënuar me *v* (angl.light verb). Kjo foljez tregon një lloj kategorie të paspecifikuar më tej, përveç pranisë ose mungesës së disa tipareve.


Tiparet në fjalë janë dy:

- a) ka një argument të jashtëm (kryefjala);
- b) cakton rasë kallëzore (kundrinore).

Në qoftë se kategoria *v* i ka këto tipare, ajo është kokë e një strukture argumentuese kalimtare që mund të përmbajë një folje që tregon gjendje (p. sh. *conoscere*), ose veprim (p. sh. *colpire*): në këtë rast ajo quhet *v** dhe sintagma që e ka si kokë shënohet *Sv**. Në ndërtimet kalimtare SN është argument i jashtëm i *Sv** dhe "foljeza" ka tiparin [caktò Rkall] që verifikon tiparin e pa interpretueshëm të SN (quell'uomo), [KALL]. Dy elementet *v** e SN dhe V e SN lidhen me anë të raportit Agree. Pra SN (quell'uomo) e merr vlerën [KALL], sepse caktohet nga "foljeza" me të cilën ndodhet në lidhjen Agree. [KALL] është tipar i pa interpretueshëm d.m.th. i pavlerësuar, ashtu si mbiemrat që gjininë e marrin nga emri që cilësojnë.¹²

¹² G. Graffi, *Ç'është gramatika gjenerative?*, Tiranë, Toena, 2010, fq.104.

P.sh. *Gianni conosce quell' uomo.*



Rrjeti tematik i një zëri të caktuar leksikor është një strukturë analoge me atë në predikat dhe argumente, tipike e analizave të gjuhës, të formuluar nga logjika bashkëkohore. Lidhjet e shprehura në një fjali si: *Vandalët plaçkitën Romën.* do të simbolizoheshin në këtë mënyrë :

a) S (x,y) b) x = v c) y = r

S është simboli i predikatit *plaçkis* që merr dy argumente, x dhe y; "v" dhe "r" tregojnë dy vlerat e marra nga argumentet (*Vandalët* dhe *Roma*). Në këtë analizë predikati përcaktohet në lidhje me të gjitha argumentet, ku asnjëri prej tyre nuk ka një rol të privilegjuar. Argumenti i jashtëm sipas Williams-it¹³ kryefjala mund të ketë role tematike të ndryshme edhe me të njëjtin zë leksikor, ndërsa me argumentet e tjera kjo gjë nuk ndodh kurrë. Rolet tematike nuk janë të gjitha në të njëjtin nivel, por janë të renditura sipas një hierarkie të pjesshme të shfaqur nga fakti që njëri prej tyre (kryefjala) ndryshon nga të tjerët. Është parimi i projeksionit të shtrirë (Paraqitjet e çdo niveli sintaksor, domethënë FL, struktura-th dhe struktura-s, janë të projektuara nga leksiku dhe të gjitha fjalitë duhet të kenë një kryefjalë), që imponon realizimin e argumentit të jashtëm, por që nuk zbatohet në struktura emërore.¹⁴ P.sh. *Plaçkitja e Romës.*

¹³ E. Williams, *Argument structure and morphology*, in "The linguistic Review"1,1981, fq. 81-114

¹⁴G.Graffi, *Sintaksa* (Struktura të ligjërimimit), përktheu në shqip Dr. B.Topalli, Tiranë, Dituria, 2003, fq. 190-198.

Përfundime

Në këtë punim pasqyrova sipas këndvështrimit gjenerativ terminologjinë e frazës dhe klasifikimin e saj duke u mbështetur në kundërvënien mes fjalive kryesore dhe fjalive të varura. Gjithashtu pasqyrova funksionet paralele që kryejnë njësitë predikative me gjymtyrë funksionale dhe domosdoshmërinë sintaksore të plotësisht kallëzuesor. Trajtova klasifikimin e foljeve mbi bazën e numrit të nominaleve me të cilat bashkohen dhe ekzistencën e një kategorie të veçantë funksionale, të shënuar me *v*. Përdorimi i këtyre rezultateve sjell risi në analizat e strukturave të gjuhës shqipe, të formuluar nga logjika bashkëkohore si dhe në terminologjinë gjuhësore dhe konceptuale të sintaksës gjenerative të shqipes.

Bibliografia

Graffi, G., “Sintaksa” (Struktura të ligjërit), Dr. B.Topalli, Tiranë, Dituria, 2003.

Graffi, G., “Ç’është gramatika gjenerative?”, Tiranë, Toena, 2010.

Lyons, J., “Hyrje në gjuhësinë teorike”, Prof. Dr. E. Likaj, Tiranë, Dituria, 2001.

Mita, J., “Hyrje në sintaksën gjenerative”, Prishtinë, Shpresa, 2005.